

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 90, datë 28.05.2026

PËR
MIRATIMIN E RIEMËRIMIT TË ADMINISTRATORIT DHE ANËTARIT TË
KËSHILLIT TË ADMINISTRIMIT TË SHOQËRISË “FIDENTIA” SH.A. BROKER
SIGURIMESH

Në zbatim të nenit 14, pika 22, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të neneve 204 e vijim të ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, rregullores nr. 48, datë 30.06.2015 “Për kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e riemërimit të z. Përparim Isufi si administrator i shoqërisë “Fidentia” sh.a., Broker Sigurimesh, për periudhën deri në datë 04.01.2029, si dhe riemërimin e tij si anëtar i këshillit të administrimit të shoqërisë, për periudhën deri në datën 04.04.2029.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Saimir TOLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Adela XHEMALI